



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel : 04 2251267

Nr. 92/1 Prot.

Tiranë, më 19/01/2012

DEKLARATË

Unë Bujar Leskaj, në cilësinë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit:
Duke konsideruar sensibilitetin e publikut dhe pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë në lidhje me standartet më të larta të llogaridhënies së zyrtarëve publikë;
Duke ushtruar të drejtën që më njeh neni 22, pg.1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për të shprehur lirisht vullnetin tim; si dhe
Duke respektuar nenin 18, pg.1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për barazinë e shtetasve para ligjit:

DEKLAROJ:

Është vullneti im i lirë që të jap paraprakisht pëlqimin për heqjen e imunitetit për çdo rast të fillimit të ndjekies penale për veprat penale që lidhen me ushtrimin e funksionit të parashikuara nga Kodi Penal, në çdo rast në të cilin do të kërkohet miratimi i Kuvendit.

Është vullneti im i lirë që të ushroj funksionet e mia si Kryetar i KLSH, si i parë mes të barabartëve, pa qenë nevoja që mbrojtja ligjore për mua të jetë e ndryshme nga ajo që ligji u njeh kontrollorëve të KLSH.

Ky deklaram bëhet pasi janë marrë në konsideratë, nenet 165, pg.2 dhe 137, pg.1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 14 i Ligjit Nr.8270 datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" me ndryshimet përkatëse dhe Vendimi nr.212 date 29.10.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

Ky deklaram është i vlefshëm për të gjithë periudhën nga momenti i fillimit të ushtrimit të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit e deri në përfundim të tij.

KRYETARI

Bujar LESKAJ